



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT & MBROJTIES SË  
KONSUMATORIT.  
QËNDRA E TRANSFERIMIT TË TEKNOLOGJIVE  
BUJQËSORE, VLORË.**

**PROJEKT: KËRKIM NË FERMË**

**RAPORT-PËRFUNDIMTAR.**

**Titulli i projektit:**

**:"Zbatimi i elementëve të veçantë teknologjikë në ullishtet intensive"**

**Afati i zbatimit viti 2011:**

**Drejtuesi i projektit  
Dr. Zaim Veshaj**

**Q.T.T.B.VLORË  
DREJTORI  
Pr.As. Dh.Panajoti.**

Projekt kërkim në fermë

Raport përfundimtar

**Titulli i projektit: "Zbatimi i elementëve të veçantë teknologjikë në ullishtet intensive"**

## Hyrje

Shqipëria është një vend me kapacitet prodhues në ulli prej rreth 50 000 ton ulli në vit dhe rreth 6000 ton vaj. Ullishtja zë 41 000 ha të shpërndarë në rreth 90 mijë ferma të vogla. Në sipërfaqen bujqësore ullishtja zë rreth 6.3% të tokës së punueshme. Vlera e prodhimit bujqësor të sektorit të ullirit është rreth 16 milion €. Puna e krahut për shërbime e vjelje arrin në rreth 1 milion ditë pune. Këto të dhëna i japin rëndësi ullirit jo vetëm në planin socioekonomik por edhe në atë pejsazhistik.

Nga vitet '50 në '90 rritja e sipërfaqes është 4,1 herë ndërsa prodhimi 1,6 herë, më rritje vjetore në sipërfaqe 10,2 % dhe në prodhim 4,1 %.

Sipas statistikave nga viti 1992 ne 2010 janë shtuar rreth 4 milion bimë të mbjellë në oborre ose parcela të vogla në zonat fushore dhe kodrinore vetëm në vitin 2010 u mbollën 1 milion rrënjë.. Burim i materialit janë fidanishtet e vëndit dhe materiali i importuar kryesisht nga Italia, Greqia, material ky i pa kontrolluar dhe në shumë raste me varietete të pa studiuara për përshtatshmërinë në kushtet klimatike të Shqipërisë.

Studimi i ullirit i dha dhe do ti jap dhe për të ardhmen impuls të ri shtimit të sipërfaqeve me ullishte të reja. Brënda një periudhe të shkurtër do të mbillen rreth 20 milion rrënjë por nuk do të lihet pas dore edhe kujdesi për ullishtat e mbjella në drejtim të mirëmbajtjes, kryerjes së shërbimeve agroteknike për të siguruar prodhim të përvitshëm dhe të qëndrueshëm. Mbjellia e ullishteve të reja do të bëhet në baze të një planifikimi real për strukturën e kultivarëve, tipin e ullishtes, mekanizimin, vënien nën ujë etj. Të gjitha këto hallka të kartës teknologjike kanë rëndësi të veçantë ku neglizhimi i njërës prej tyre influencon dhe tek të tjerat dhe për rrjedhojë ka ndikim direkt në prodhimtarinë e ullirit dhe rentabilitetin ekonomik të ullishtes.

Në stadin aktual në mbjelliet e reja përparësi do tu jepet ullishteve intensive.

Me ullishte intensive kuptojmë jo vetëm dendësi të lartë bimësh duke filluar nga 300-600 bimë por dhe intensifikim të shërbimeve që do të zbatohen në këtë kategori.

Për tu ardhur në ndihmë fermerëve që kultivojnë të tilla ullishte si dhe tu përgjigjemi kërkesës së disa fermerëve të qarkut të Tiranës, Fierit dhe Vlorës po përgatitim projektin e kërkimit në fermë me titull: "Zbatimi i elementëve të veçantë teknologjikë në ullishtet intensive"

### **Objektivi i kërkimit.**

Objektivi themelor i kësaj prove është të përcaktojmë ndikimin e plehrit organomineral dhe të krasitjes në prodhimtarinë e ullirit.

### **Studimi u krye në vitin 2011**

**Personi përgjegjës -Nga Q.T.T.B.-ja: Dr. Zaim Veshaj.**

**Personi përgjegjës nga D.R.B.U.M.K. Vlore, Tirane & Fier zoterinjt: Shemi Roshi, Zydi Cuhllaj dhe Etem Bitaj si dhe ekstesionistet: Dhimiter Shahini Komuna Novosele Vlore, Bekim Besho Komuna Cakran Fier, Hazir Hykaj ekstesionist i Bashkisë Vore Tirane.**

Studimi u krye në fermat që kultivojnë e ullnj të mbjella në ullishte me moshë mbi 6 vjet në cv Frantojo në teren kodrinor me lartësi deri në 200 m mbi nivelin e detit në Komunën e Novoseles fshati Trevllazer me fermer Solol Myrtaj, në Komunën e Cakranit në teren fushor në kultivarin Frantojo me moshe mbi 7 vjet me fermer Flamur Beshaj dhe në Bashkinë Vore fshati Picar fermer Ardian Subashi.

### **Metodat dhe materialet e përdorura**

**Përshkrimi i metodologjisë së kërkimit:**(metoda e kampinimit: numri i fermerëve pjesmarrës dhe kriteret e seleksionimit, skema e eksperimentit, shkurtimisht)

Provat u ngriten në ullishte me moshë 5-10 vjeçare të tipit intensiv me distance mbjellie 5 m X 6 m me dendësi 330 bime/ha në katër variante me tre përsëritje

. Për sejcilin variant do krahasohen midis tyre këta tregonjës:

- 1.Periudha e lulëzimit të bimëve nr i luleve të çelura
- 2.Përqindja e frutave të lidhur krahasuar me lulet e çelura.
- 3.Përqindja e frutave të mbajtur deri në vjelie krahasuar më lulet e çelura.
- 4.Prodhimi për çdo variant dhe përsëritje.
- 5.Analizat kimike të yndyrës(% e yndyrës,aciditeti,lënda e thatë). .
- 6.Zhvillimi vegjetativ i bimës në përgjithësi, gjykuar nga masa vegetative vjetore.
- 7.Shpënzimet e kryera efektiviteti ekonomik i studimit.

#### SKEMA E NGRITJES SË PROVËS

<b>V.1P1</b>	<b>V.2P1</b>	<b>V.3P1</b>	<b>V.4P1</b>
<b>V.2P2</b>	<b>V.3P2</b>	<b>V.4P2</b>	<b>V.1P2</b>
<b>V.3P3</b>	<b>V.4P3</b>	<b>V.1P3</b>	<b>V.2P3</b>

**V1 –dëshmuksi eksperiencia qe përdor fermeri.**

**V2 –plehërim i kombinuar.**

**V3– krasitje prodhuese.**

**V4-plehërim i kombinuar + krasitje prodhuese..**

**Për ngritjen e studimit për një fermer u vunë në dispozicion 36 bimë,**

Kërkimi është i tipit “Provë” i ngritur në 4 variante me 3 përsëritje.

Në fermat që ndodhen në Komunën Novosele fshati Trevllazër, toka është H.K.Algj, teren kodrinor.Lartësia mbi nivelin e detit deri në 200 m., me drejtim veri-jug me ekspozicion jug-veri.Ullinjt janë mbjell nga fermeri Sokol Myrtaj ne vitin 2004 në teren të pa sistemuar ne drejtim te pjerrësisë së parcesme vetullore për çdo bimë ulliri me sipërfaqe të sheshte prej 4 m2.

.Në fermën e komunës së Cakranit ullishtia shtrihet në teren fushor në afërsi të luginës së Vjosës.. Nga përbërja agropetologjike këto toka rezultojnë të pasura ,të thella, H. K. A me përmbajtje të lartë të fosforit dhe potasit të dobëta në përmbajtjen e lëndëve të azotuara.

Në bashkinë e Vorës toka shtrihet në një teren të lehtë kodrinor 100 m mbi nivelin e detit. Toka nga perberia pedologjike sipas studimit të kryer është H.K.A. të mesëm në përmbajtje fosfatike dhe potas dhe të varfëra në lëndë azotike. Ullishtet e vjetra në këtë zonë e ndejnë mungesën e lëndëve ushqyese gjë që vrehet në zhvillimin e bimeve në përgjithësi dhe të prodhimit në veçanti Në ullinjt shekullor të kësaj zone prodhimi periodik është mjaft i theksuar (sipas sondazhit të kryer me 20 fermer)

Në këtë zonë përfshi dhe fermen e marë në studim në vitin 2011 prodhimi ishte në kufij tepër minimal pothuajse të pa përfillshëm. Negativisht ndikoi dhe thatsira e zgjatur e verëqë kaloi me mungesë të reshjeve. Kjo ndikoi negativisht jo vetëm në mbajtjen e frutave të lidhur por dhe të rritjes vegetative të bimëve.

Prova në këtë fermë u përjashtua nga përpunimi i të dhënave studimore duke u quajtur të dështuar Analiza u krye për dy fermat e tjera të komunës Novoselë në Vlorë dhe të Cakran në Fier.

## Rezultatet

### Përpunimi statistikor i treguesëve të provës.

#### *Cultivari Frantojo ferma në fshatin Trevllazer fermer Sokol Myrtaj.*

VITI 2011

FRANTOIO LULËZIMI				
Nr	Level	Mesatare	Homogjen Groups	+ / - Limits
1	V1	330.5	a	60.4972
2	V2	341.0	a	60.4972
3	V3	342.5	a	60.4972
4	V4	419.0	b	60.4972

FRANTOIO FRUTA TE MBAJTUR (Para vjeljes)				
Nr	Level	Mesatare	Homogjen Groups	+ / - Limits
1	V1	10.18	a	7.90021
2	V2	11.93	a	7.90021
3	V3	14.12	a	7.90021
4	V4	17.11	b	7.90021

FRANTOIO PRODHIMI				
Nr	Level	Mesatare	Homogjen Groups	+ / - Limits
1	V1	14.1	a	3.32298
2	V2	15.9	ab	3.32298
3	V3	17.7	b	3.32298
4	V4	22.1	c	3.32298

V- I dëshmues	14 kg/rr
V- II plehërim organomineral	16 kg/rr
V- III krasitje prodhuese	18 kg/rr
V- IV pleherim organomineral + krasitje prodhuese	22 kg/rr

**Cultivari Frantojo ferma në fshatin Cakran fermer Flamur Beshaj.**

V- I dëshmues	13 kg/rr
V- II plehërim organomineral	17 kg/rr
V- III krasitje prodhuese	19 kg/rr
V- IV pleherim organomineral + krasitje prodhuese	24 kg/rr


**Vlerësimi i rezultateve**

Mbështetur në treguesit e prodhimit për të dy fermat e mësipërme me ndryshime shumë të vogla midis varianteve dhe përsëritjeve si dhe të njëjtit kultivar dhe kohë mbjellie për analizë u mjaftuan me fermën në komunën Novoselë të fshatit Trevllazër

**ANALIZA E VARIANCES(per prodhimin)**

Cv .FRANTOIO PRODHIMI kg/rr				
Nr	Varianti	Mesatare	Grupet	+ / - DMV
1	V1	11	a	3.32298
2	V2	15.9	ab	3.32298
3	V3	17.7	b	3.32298
4	V4	22.1	c	3.32298


**Grafik1 ferma Trevllazër**



## Raporti lule të lidhura fruta të mbajtur

Varianti	Lule të lidhura	Fruta të mbajtur
V1	330,5	10,18
V2	341	11,93
V3	242,5	14,12
V4	419	17,11

## Grafiku2



Siç shihet nga tabela e rezultateve të prodhimit dhe përpunimi statistikor i treguesëve të marë në studim , ndryshimi nga varianti në variant në raport me dëshmuesin është i dukshëm .ndryshimet statistikore na krijojnë në tabelën e rezultateve katër grupe homogjene gjë që vërteton më së miri efektin e sejcilit faktor të marë në prove .Dëshmuesi na paraqet një grup më vete varianti i dytë me përdorim të plehut organomineral na jep një grup ab ,efekti i krasitjes na percjell nje grup me vet si dhe kombinimi i plehut organomineral me krasitjen na nxjerr në pah një grup më vete.

Ndërsa në përpunimin statistikor të tregonjësve të lulëzimit, lidhjes së frutave dhe mbajtjes së tyre deri në kohën e vjelies na kemi dy grupim .Për tre varjantet e pare (V1,V2,V3) kemi nje grupim ndërsa për variantin e katërtë kemi një grup me vete.

Arsyetimi ynë për këtë fenomen shpjegohet me faktin se bima e ullirit aq më shumë bimë tepër të reja në moshë nxiten pak ose aspak nga veprimtari të veçanta si plehrimi apo krasitja të kryera në vitin në vazhdim1-2 muaj përpara lulëzimit.Dihet që për pregtatitjen e prodhimit për vitin pasëardhës bima pregatitet një vit më parë e cila shprehet në vegjitacionin që ka zhvilluar në vitin e kaluar.Këto ndërhyrje si plehërimi ashtu dhe krasitja kanë influenc më shumë pas lulëzimit dhe lidhjes së frutave gjë që duket qartë në tabelë dhe në paraqitjen grafike me influencë të dukshme ne raportin e luleve të mbajtura ndaj atyre të lidhura si dhe në prodhimin

për çdo variant dhe përsëritje.

Nga momenti i lidhjes deri në vjelje fruti i ullirit kalon disa faza gjatë të cilave pëson ndryshime si në formë dhe në përmbajtjen e tij.

#### FAZA I-rë

- Menjëherë mbas lidhjes së frutit kemi shtim të shpejtë të qelizave, e cila ndikon në zmadhimin e tij dhe të bërthamës. Bërthama në mbarim të kësaj faze arrin madhësinë normale por ende nuk drunjëzohet. Në këtë fazë fruti përmban më shumë ujë se sa lëndë organike, duke qënë ende i butë preket më shumë nga miza Në këtë fazë fruti ka nevojë më shumë për lëndë azotike .

#### FAZA II-të

- Përkon nga fundi i Korrikut dhe fillimi i Shtatorit, vërehet një ngadalësim i rritjes së frutit ndërsa embrioni merr rritjen e tij normale, formohet guacka dhe fillon forcimi i saj. Në këtë fazë bima e ullirit ka nevojë për ujë dhe lëndë ushqimore sidomos ato azotike

#### FAZA III-të

- Në frut rifillon një rritje më e shpejtë si dhe shtohet volumi i qelizave të cipës mbështjellëse dhe të tultit. Gjithashtu fillon të shtohet sasia e bulëzave të vajit dhe të dallohen njollat e para me ngjyrë të kuqërremtë mbi cipën mbështjellëse. Me shtimin e ngjyrës fruti zbutet dhe në të mbizotërojnë komponimet organike. Në këtë fazë rrëzimi i frutave shkon afërsisht nga 5 - 25% e frutave të mbetur në bimë nga faza e dytë. . Në këtë fazë bima e ullirit ka nevojë për ujë dhe lëndë ushqimore sidomos ato azotike, potasike e fosforike.janë këto momete që vendosin për prodhimin e vitit në vazhdim dhe përgatitjen e bimës për prodhimin e vitit të ardhshëm.

### Vlerësimi ekonomik.

#### Tregues për efektivitetin ekonomik të provës.,ferma Trevllazër Komuna Novoselë Vlorë

Varianti	Pr.Kg/rr	Ç.m. i shit.	Të ardh.leke	Shpenzimet	E ardh.neto.
V-I.	11	100 L/kg	1100	600	500
V-II .	16	100 L/kg	1600	800	800
V-III.	18	100 L/kg	1800	900	900
V-IV.	22	100 L/kg	2200	1000	1200

#### Tregues për efektivitetin ekonomik të provës.,ferma Cakran Fier

Varianti	Pr.Kg/rr	Ç.m. i shit.	Të ardh.leke	Shpenzimet	E ardh.neto.
V-I.	13	100 L/kg	1300	600	700
V-II .	17	100 L/kg	1700	800	900
V-III.	19	100 L/kg	1900	900	1000
V-IV.	24	100 L/kg	2400	1000	1400

Nëpërmjet analizës së kostos së prodhimit për çdo variant janë evidentuar të gjitha shpenzimet vjetore të kryera të përmbledhura në bazë materiale dhe shpenzime pune. .Vlera e materialeve është

Ilogaritur mbi mesataren e çmimit që blihen në tregun me pakicë ,ndërsa për punën e krahut është parashikuar vlera mesatare e ditës së punës. Bazuar në këto të dhëna është përlllogaritur e ardhura neto, e cila ka dalë nga të ardhurat e realizuara minus shpenzimet e kryera.Nga kjo analizë konstatojmë se në variantin e III-të dhe të IV-të edhe pse janë relizuar më shumë shpenzime e ardhura neto është më e lartë si rezultat i prodhimit dhe të ardhurave më të mëdha të ralizuara në krahasim me variantet e tjerë

E ardhura neto (fitimi) i realizuar në variantin e IV është 2 herë më i larta se në variantin kontroll dhe 50 % më shumë se në variantin e dytë dhe të tretë.

Në këtë sfond del efekti që ka krasitja prodhuese e kombinuar me plehërimin organomineral tek kultura e ullirit

Në të dyja feramat që është ngritur prova ullishtet janë të reja të sapo futura në prodhim.Mbas disa vitesh kur ullishtia të ketë hyrë në prodhim të plot do të trfishohet prodhimi dhe njëkohësisht e ardhura neto.

E ardhura neto do të rritet edhe më shumë në qoftë se fermeri e përpunon frutin dhe shet vaj.

### **Diskutime dhe konkluzione.**

Bazuar në rezultatet e vitit të parë të cilat nuk janë të mjaftueshëme për kohën prej një viti të ndjekies së kësaj prove studimi (minimumi duhet të ishte 2-3 vjet) për një argumentim më të plot nxjerrim disa përfundime bazuar këto dhe në eksperiencën shumë vjeçare që ka Q.T.T.B-ja në këtë fushë.

-Për një ullishtari efektive me retabilitet ekonomik pozitiv duhet zbatuar tërësisht karta teknologjike e mirërritjes.

-Të gjitha shërbimet agroteknike janë të nevojshme që të kryhen nga fermeri por në mënyrë të veçantë nuk duhet të neglizhohet me plotësimin e nevojave që ka bima për lëndë ushqyese si dhe kryerien e përvitëshme të krasitjes prodhuese.

### **Me anë të plehërimit ne ndikojmë në shumë aspëkte fiziologjike të jetës gjatë ciklit jetësor i cili avantazhon në disa drejtime:**

1-Në shpejtimin e rritjes së bimës në etapën e rinisë

2-Në futien më herët në prodhim të ullishteve të reja

3-Në stabilitetin e prodhimit gjatë etapës së prodhimtarisë

4-Në zgjatien e fazës së produktivitetit të bimëve

5-Në rinovimin e shpejt të kurorës së bimëve në etapa të ndryshme të ciklit të jetës sidomos në periudhën e plakies.

### **Krasitja ka efekte të shpejta dhe të dukëshme në aktivitetin jetësor dhe prodhues të bimës së ullirit.**

Me anë të krasitjes në bimë arrihen disa përfundime :

1-Krijohen raporte të qëndrueshme midis masës drusore dhe asaj të gjelbër gjethore.

2-Krijohen raporte të drejta midis masës ajërore dhe asaj tokësore

3-Vendosen raporte të regullta midis sasisë dhe cilësisë së prodhimit.

4-Krijohen kushte për rritjen e nivelit të mekanizimit të shërbimeve agroteknike

5-Ndihmon në ulien e infeksionit nga sëmundjet dhe dëmtonjësit e ndryshëm si rezultat i pakësimit të rezervës biologjike në bimë si dhe influencës së dritëzimit dhe ajërimit me të mirë të bimës, si dhe mundësisë më të mirë të kryeries së trajtimeve kimike

6-Ndikon në ulien e shpenzimeve për vjelien e ullirit.

Që efektet e plehërimit dhe të krasitjes të jenë të qëndrueshëme, ato duhet të kryhen çdo vit Plehërimi organik meqënëse nuk konsumohet i gjithi në vitin e pare këshillojmë që të bëhet i herë në 2 ose 3 vjet me norma plehu në përshtatje me moshën e ullishtes, tipin e ullishtes (ekstensive, intensive dhe superintensive ) ujitjen e bimëve etj.Në ullishtet e reja intensive me 350 bimë/ha do të rekomandonim hedhjen e plehut organik në çdo 2 vjet në sasin 25-30 kg/rr si dhe plehërim të përvitshëm me plehra kimik N.P.K 2-3 kg/rr i shpërndar në 3 duar -para diferencimit të sythave frutor në vitin pas një prodhimi të bollshëm, -gjatë lulëzimit dhe - në periudhen e rrëzimit të madh të frutave.

,Në qoftë se jemi para një viti me prodhim të madh plehrat kimike i shpërndajmë dozen e parë pas



proçesit të diferencimit të sythave frutor, mbas 15 shkurtit, dozën e dytë pas lidhjes së frutave në fund të muajit maj 10 ditori i parë i muajit qershor, dhe dozën e tretë para rrëzimit të madh të frutave fundi korriku fillimi gushtit

Krasitja duhet të kryhet në periudhën e qetësisë së bimëve., kjo periudhë vjen kur temperatura maksimale zbret nën 10 gradë C dhe vazhdon gjatë gjithë kohës deri në momentin e fillimit të diferencimit të zythave frutor periudhe kjo për zonën e ulët bregdetar pas 10-15 shkurtit, dhe deri në 10-15 mars për zonat e larta kodrinore të Shqipërisë së brëndëshme si Berati, Elbasani, Tirana, Kruja, Lezha, Tepelena etj.

### **Mesazhet e ekstesionistit**

1-Ruajtja e vëllimit optimale të kurorës për prodhim të rregullt. është objektivi i parë i krasitjes Një bimë që nuk është krasitur prodhon fruta më shumë se kapaciteti i të ushqyerit mund të merren fruta të vegjël që kanë një rënie të theksuar në vere dhe përmbajtje të ulët të vajit Një krasitje e fuqishme në vitin e prodhimit mund të zvogëlojë aktivitetin riprodhues . Gjatë kryerjes së këtij aktiviteti të orjentohemi nga parimet bazë të krasitjes

1)-Në dy bime te ndryshme bima e shëndosh krasitet me lehtë., bima e dobët krasitet më tepër.

2)-Në një bimë dega më e dobët krasitet me lehtë .,dega me e fuqishme krasitet më shumë..

### **Pleherimi.**

Si çdo e bimë e specieve të tjera ulliri gjatë ciklit të jetës ka nevojat thelbësore për gjashtëmbëdhjetë elementë.

Karboni (C), hidrogjen (H), oksigjenit (O), azotit (N), fosforit (P),

(K) kalium, magnez (Mg), kalcium (Ca), squfurit (S), hekuri (Fe), mangani (Mn), zinkut (Zn), Bakri (Cu), Mo) molibden, bor (B) dhe klorin (Cl).

**Tre element si C, H, dhe O, janë jo-minerale dhe përbëjnë rreth 95% të peshës së thatë të një bime ulliri**

**Trembëdhjetë elementët e tjerë janë minerale kontributi i të cilëve është qëllimi i plehërimit.Së bashku, përbëjnë vetëm rreth 5% të peshës së thatë të ullirit.**

Bima e ullirit thith elemente ushqyesve nëpërmjet rrënjëve nga toka, ku ata janë të pranishëm në formë të joneve, është e rëndësishme që këta elementë në gjethe të jenë me njëri-tjetrin në një marrëdhënie të balancuar..

E vetmja gjë që përcakton nevojat për element ushqyes në bimë është analiza e përmbajtjes së elementëve ushqyes në tokë.Nga shumë metoda për përcaktimin e përmbajtjes së elementëve ushqyes me e mira është analiza e gjethes e cila kërkon punojnës të kualifikuar dhe laborator të kompletuar me pajisje të përshtatëshme.

Analizat e tokës duhet të kryhen të paktën 1 herë në 4 vjet.

**Llogaritja e plehërimit të tokës së mbjellë me ullinj duhet të kryhet mbi bazën e prodhimit të marë në vitin në vazhdim, në prodhimin që mendohet të meret në vitin e ardhshëm, tipin e ullishtes dhe agroteknikën e përdorur duke përdorur normativa e këshillueshëme nga specialistët përkatës.**

REALIZIMI I BUXHETIT TË PROJEKTIT PËR PERIUDHËN janar-dhjetor '2010.

### **21. BUXHETI – (I detajuar sipas zërave të 602)**

Shprehur në 000/lek

#### **I Nevoja për bazë materjale**

1.Kanceleri (flet,letër shk etj)	=	5000 lek
2.Pleh kimik.	=	8000 lek
3.Gaz për ngrohje	=	2000 lek
4.Pesticide	=	5000 lek
<b>SHMA BAZË MATERJALE</b>	=	<b>20000 lek</b>

## **II. Nevoja për fond page**

1.Shërbime udhëtimi Vlorë- Tiranë e kthim,	5 ditë x 6700 = 33500 lek
2.Shërbim ekstesionisti Tiranë-Vorë e kthim	7ditë x 500 = 3500 lek
2. Shërbime udhëtimi Vlorë-Fier Cakran e kthim	10 ditë x 1600 = 16000 lek
<b>4.Shuma</b>	<b>= 53000 lek</b>
<b>TOTALI I + II =</b>	<b>= 73000 lek</b>

**21. BUXHETI – (I detajuar sipas zërave të 602)**  
Shprehur në 000/lek

**21.Realizimi i BUXHETI – (I detajuar sipas zërave të 602)**  
Shprehur në 000/lek

<b>Nr. i artikullit</b>	<b>Emertimi i Artikullit</b>	<b>Plan vjetor 000/lek</b>	<b>Realizimi vjetor ne 000/lek</b>
	Buxheti vjetor	<b>73</b>	<b>73</b>
	Bazë materiale	<b>20</b>	<b>20</b>
	1.Kanceleri (flet,letër shk etj)	5	5
	2.Pesticide	5	5
	3.Pleh kimik	8	8
	4.Gaz per ngrohje	2	2
	<b>Udhëtim e djeta</b>	<b>53</b>	<b>53</b>
	1.Shërbime udhëtimi Vlorë-Fier-Cakran e Kthim	16	16
	2.Shërbime udhëtimi Vlorë-Tiranë	33,5	33,5

Studimi u realizua në bashkëpunim të plot më ekipin e projektit specialist të fushës së bujqësisë(agronom+ekonomist) nga Q.T.T.B-ja Vlorë dhe ekstesionistët e fermeret e fermave në Trevllazër , Cakran dhe Vorë.

Duhet theksuar se bashkëpunimi ka qënë i mirë .Ekstesionistët e shërbimit këshillmor u përfshinë në të gjitha aktivitetet e planifikuara duke dhënë ndihmesën e tyre në momente të veçanta të zbatimit të projektit.

Për vitin e ardhshëm më shërbimin ekstesionist të kësaj drejtori do të zhvillohen demonstrime mbështetur në rezultatet e aritura nga studimi i kryer në vitin 2011.

Raporti përfundimtar pasi u pregatit nga drejtuesi i projektit në bashkëpunim me aktoret e tjerë,u firmos nga shefat e shërbimit të këshillimit të drejtorive rajonale të bujqësisë.

Raporti shoqërohet me fletë palosie e cila do tu vihet në dispozicion fermerëve në momente të demonstrimit të studimit dhe atyre që janë të interesuar të zbatojnë këshillat e mësipërme

## **BIBLIOGRAFIA**

AA.VV. – L'olivo. Reda, Roma, 1981.

Baldy C., Lhotel J.C., Hanocq J. F. – Effetti della radiazione solare nella funzione fotosintetica dell'olivo

(Olea europaea L.). Olivae 8, 18-23, 1985.

Barranco D., D. Fernandez-Escobar, L. Rallo - El cultivo del olivo. Mundi-Prensa, Madrid, 1997.

Ben Rouina B., Omri A., Trigui A. – Effect of hard pruning on trees vigor and yields of old olive orchards.

Morettini A.-Olivicoltura. Reda, Roma, 1972.  
 monocono e a vaso in diverse cultivar di olivo. Rivista di Frutticoltura, 7-8, 1998.  
 Tan M. – Effetti della potatura e della concimazione fogliare sulla qualità e sulla resa del frutto degli olivi della varietà Edremit Yaglik. Olivae, 68, 32-36, 1997.  
 Tombesi A. - Impianto dell'oliveto e forme di allevamento. “L'Olivicoltura mediterranea verso il 2000”  
 Atti VII International Course on Olive Growing – Scandicci, 6-11 maggio 1996.  
 Tombesi A. - Olive Orchard installation, Soil arrangement, Planting density and training. Proceedings International Seminar on Olive Growing, Chania, Crete, Greece, 18-24 May, 1997.  
 Tombesi A., M.Boco, M. Pilli, D. Farinelli - Influenza della potatura sulla raccolta meccanica delle olive con vibrator di tronco. Rivista di Frutticoltura, 10, 2000.  
 Tombesi A., M.Boco, M.Pilli – Microclima del frutto: influenza della luce sull'accrescimento e sulla sintesi dell'olio. Rivista di Frutticoltura, 7/8, 1998.  
 Tombesi A., M. Boco, M. Pilli, P.Guelfi , G.Nottiani –Efficienza e prospettive della raccolta meccanica delle olive. L'Informatore Agrario, 25, 49-52, 2004.  
 Tombesi A., M. Pilli, M. Boco – Prime valutazioni su intensità e periodicità della potatura nell'olivo.  
 Boletín de Suelos 38 / 2. Romé Fernández-Escobar, R., 2001. Fertilización. Né: D. Barranco, R. Fernández-Escobar, L. Rallo (Eds.), El, Madrid. Pp. 724.

D.B.U.M.K.Vlorë.Sh.Sh.K.Shemsi Roshi  
 D.B.U.M.K.Fier.Sh.Sh.K.Hetem Bitaj  
 D.B.U.M.K.Tiranë.Sh.Sh.Zydi Çuhllaj

Fermer :Sokal Myrtaj  
 Flamur Beshaj  
 Ardian Subashi

Drejtuesi projektit .  
 Dr.Zaim Veshaj.

Shefi i financës.  
 Vangjel Buzo

Drejtori.  
 Q.T.T.B.Vlorë.  
 .Pr.As.Dh.Panajoti.

